

V E N D I M
Nr. 447, datë 26.9.2002

PËR RISHPËRNDARJEN E FONDEVE BUXHETORE PËR VITIN 2002

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 14 të ligjit nr. 8847, datë 19.12.2001 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Gjykatës Kushtetuese, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, në zërin “Shpenzime operative” t’i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh.
 2. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, në zërin “Shpenzime operative”, t’i pakësohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Gjykata Kushtetuese për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano